



REPUBLIKA E KOSOVËS




REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/41/19
Datë: 08.01.2020 .



Në bazë të nenit 12,pika b, paragrafi 12.4, nenit 40.2, shkronja a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 29, të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.12.2019, nxjerrë:

V E N D I M

për miratimin e

plotësim ndryshimit të Rregullores për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e Komunës së Junikut

- I. Me këtë vendim miratohet **plotësim ndryshimi i Rregullores për caktimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e Komunës së Junikut** /në tekstin e mëtejme Rregullorja/.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja e miratuar nga pika I. e këtij vendimi.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut dhe drejtoria për SHPM dhe SH.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.
- Me këtë vendim njoftohen:
1. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
 2. Kryetari i Komunës së Junikut;
 3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
 4. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut


Muharrem Krasniqi

kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270
<http://rks-gov.net/junik>



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika c të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 40 dhe 57, paragrafi 57.1 i ligjit Nr. 04/l-005 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/18 për Tregtinë e Brendshme, Rregullorës (MAPL) nr. 01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, si dhe neni 10 pika a, neni 22 paragrafi 22.1 pika 3, të Statutit të Komunës së Junikut, Kuvendi komunal në mbledhjen e mbajtur me dt.27.12.2019 miraton këtë:

Draft: RREGULLORE PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË RREGULLORËS PËR CAKTIMIN E ORARIT TË PUNËS PËR SUBJEKTET AFARISTE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË JUNIKUT

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i Orarit të Punës për të gjitha veprimtaritë afariste, hoteliere, zejtare dhe shërbyese të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në territorin e Komunës së Junikut.

Neni 2

Të gjitha subjektet afariste të themeluara dhe të regjistruara në pajtim me dispozitat ligjore që ushtrojnë veprimtari afariste janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

Orari i fillimit dhe mbarimit të punës i përcaktuar me këtë Rregullore duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit, në të cilin kryhet veprimtaria afariste dhe duhet saktësuar:

- a) Fillimi dhe mbarimi i Orarit të Punës,
- b) Ditët që nuk punohet,
- c) Rastet e veçanta,
- d) Pauzën ditore.